



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZL.Anr.438/2025**

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj - kryesues, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me administrimin e numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës për Raundin e Dytë për Kryetar Komune që janë mbajtur më datë 09.11.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2025, merr këtë:

### **VENDIM**

**KONSTATOHET** e tërhequr ankesës ZL. A.nr. 438/2025 e datës 11.11.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur me administrimin e numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN).

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) lidhur parregullsitë gjatë numërimit të fletëvotimeve në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) ku ka theksuar se ka vërejtur mospërputhje të rezultateve preliminare dhe atyre të QKN-së në lidhje me vendvotimin 1928/04 në qendrën e votimit Pavarësia në Matiqan.

Me datë 12.11.2025, ankuesi ka parashtruar kërkesën me Nr. Protokolli 438/3 për tërheqjen e ankesës ZL. Anr.438/2025 të datës 11.11.2025, kundër KQZ-së me arsyetimin pasi që e njëjta është rregulluar në sistemin zyrtar të evidentimit të rezultateve në QKN e QNR.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 11 paragrafi 8 i Rregullores nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-së, si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
ZL.Anr.438/2025, datë 12.11.2025

Kryesues i Panelit  
Kymete Kicaj

